



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic Kosovo



Komuna e Istogut  
Opština Istog  
Municipality of Istog

01 Nr. 308 / 2024  
04.06.2024

KRYETARI / PRESDENNIK / MAYOR

<https://kk.rks-gov.net/istog/>  
Tel: 038/ 200 438 14

## NJOFTIM

Në bazë të neni 68, paragrafi 3 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe në bazë të nenit 22 paragrafi 1.5, neni 31 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë si dhe Statutit të Komunës 01 Nr.62/-010 të miratuar me datën 30.11.2010, Kryetari i Komunës së Istogut në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim Publik organizon:

## DËGJIM PUBLIK

për

### KORNIZËN AFATMESME BUXHETORE – KAB 2025-2027

Të nderuar qytetarë të Komunës së Istogut, ju ftojme që të merrni pjesë në Dëgjimin Publik për: **Kornizën Afatmesme Buxhetore – KAB 2025-2027.**

Dëgjimi Publik do të mbahet me datë **19 Qershor 2024** duke filluar nga ora **11:00**, në **sallën e Kuvendit të Komunës së Istogut.**

Ky Dëgjim Publik, organizohet nga Kryetari i Komunës së Istogut në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Informim Publik.

Me qëllim që qytetarët të njihen rreth këtij dokumenti, Komuna e Istogut, konkretisht Zyra për Informim ka publikuar njoftimin dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore – KAB 2025-2027 në ueb faqen zyrtare të Komunës së Istogut, <https://kk.rks-gov.net/istog/category/degjimetbuxhetore/> në rubrikën Dëgjimet Buxhetore.

Këto diskutime publike janë të hapur për të gjithë qytetarët e Istogut, duke përfshirë shoqërinë civile, profesionistët dhe ekspertët e fushave relevante, andaj ftoheni të gjithë pa dallim të merrni pjesë në Dëgjim Publik.

Kryetari i Komunës  
**Z. Ilir FERATI**